



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800435/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda: Rekomandojmë rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit R.R.

Drejtuar: Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore

V L O R Ë

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi R.R, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosmarrje përgjigje për kërkesën e bërë për rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e tij.

Sipas shpjegimeve të tij, shtetasi R.R është përfitues i pensionit të pleqërisë që nga data 15.12.2002. Ka punuar si ushtarak dhe pretendon se masa e pensionit të pleqërisë është caktuar më e ulët se e kolegëve të tij në pension, bazuar në punën e bërë dhe pagat e marra. Për këtë arsye i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë me kërkesë për rishikimin e dosjes së pensionit që në muajin Korrik 2017 si dhe në muajin Dhjetor 2017.

Duke qenë se nuk ka marrë asnjë përgjigje, pavarësisht interesimit të tij të vazhdueshëm, për t'iu mundësuar rillogaritja e pensionit të pleqërisë, ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë

rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit R.R.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI